



Date: 05/02/2019

Kërkohet Dizenjues dhe realizues spoti televiziv

Titulli i Shërbimit: Dizenjues dhe realizues i një spoti televiziv informues mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, me temë: **“Më lejo dhe mundëso përfshirjen time “**

Aplikimi është i hapur për: *Kompani dizenjimi dhe individë/ekspertë të fushës*

Vendi: *Bashkia Elbasan, njësitë administrative Labinot Fushë, Bradashesh, Papërr, Shushicë*

Organizata: *MEDPAK (Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara)*

Kohëzgjatja e shpalljes: *10 (dhjetë ditë)*

Me kompaninë / ekspertin e përzgjedhur kontrata do të nënshkruhet brenda muajit Shkurt 2019

Informacion i përgjithshëm:

Projekti “Më lejo dhe mundëso përfshirjen time “po zbatohet nga shoqata MEDPAK (Mbrojtja e të drejtave të personave me Aftësi të Kufizuara), në kuadrin e programit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor /ReLOaD” i cili financohet nga Bashkimi Europian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. Ky projekt do të zbatohet në katër njësi administrative të bashkisë Elbasan, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit

Projekti do të përfshijë punën direkte me prindërit dhe të afërm të personave me Aftësi të Kufizuara. Të forcojë kapacitetet e rrjetit të shoqatave të prindërve në bashkinë Elbasan , për tu bërë faktor veprues dhe ndikues në përfshirjen sociale të PAK në vendimarrje, duke fuqizuar shoqatat dhe grupet e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara , të jenë pjesë e proceseve të vendimarrjes.

Qëllimi dhe shërbimi:

Spoti i krijuar do të ketë për qëllim Informimin dhe Ndërgjegjësimin e institucioneve dhe komunitetit të gjerë me të drejtat e PAK dhe të gjithëpërfshirjes sociale bazuar në **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të axhendës 2030**. Ai do transmetohet në televizionet lokale në Elbasan (Tv Skampa , Best Channel) dhe do të vendoset në websiten e MEDPAK, bashkisë Elbasan, UNDP, Delegacionit të BE dhe palëve të tjera të interesuara pas miratimit nga organizata.

Përgjegjësitë e kompanisë/ekspertit të kontraktuar :

- Kompania / eksperti do të bashkëpunojë ngushtë me koordinatorin e projektit dhe grupet e prindërve të ngritura në katër njësitë administrative të bashkisë Elbasan. Ne konsultim me ta ai do të punojë për dizenjimin apo realizimin e spotit.



- Kompania/eksperti do të përgatisë më shumë se një draft-spot, i cili do të diskutohet me shoqatën MEDPAK.
- Kompania/eksperti do të realizojë spotin sipas afateve të përcaktuara në kontratë
- Kompania/eksperti gjatë gjithë kohës së bërjes së spotit do të mbajë kontakt të vazhdueshëm me shoqatën MEDPAK.

Materialet që do të përgatisë aplikanti i kontraktuar.

Spot televiziv prej 90 sek për sensibilizimin e komunitetit lidhur me të drejtat për gjithëpërfshirje sociale, bazuar në **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të axhendës 2030** me temë : “Më lejo dhe mundëso përfshirjen time “

Kostoja e transmetimit në TV do të jetë jashtë kostonë së prodhimit të spotit por eksperti/kompania do të ketë detyrë facilitimin e këtij procesi.

Dokumentat dhe kriteret e kërkuara për aplikantët.

Dokumentacioni për kompaninë

- Nipti i Kompanisë, Liçensë për ushtrimin e këtij lloji aktiviteti.
- Ekstrakt i thjeshtë dhe historik nga QKR.
- Vërtetim nga gjykata, prokuroria dhe zyra përmbarimore që nuk është në ndjekje penale
- Vërtetim nga zyra e tatimit taksave që nuk ka detyrime të pashlyera
- Punë të kryera më parë që përfshihen në këtë fushë.
- Profili i kompanisë i përditësuar
- Kostoja e punës duke përfshirë, taksat, TVSH

Dokumentacioni për ekspertin

- CV (*Curriculum vitae*)
- Letër motivimi përse kërkoni të përfshiheni në këtë thirrje
- Eksperiencë në punë lidhur me Aftësinë e kufizuar.
- Eksperiencë në fushën e bërjes së spoteve, minimum 3 vjet.
- Eksperiencë, trajnime lidhur me të drejtat e PAK
- Aftësi logjistike dhe planifikuese, për të realizuar në kohë spotin televiziv.
- Kostoja e punës duke përfshirë , taksat,TVSH.

Të gjithë të interesuarit të dërgojnë aplikimin e tyre deri në datën 15 shkurt 2019, ora 17.00, në adresën e postës elektronike: info@medpak.org